

18.2 MONOGRAFITË NË DISA PJESË

Bëhet fjalë për monografitë, për të cilat merrni pjesë të veçanta, të cilat më vonë i lidhni në së bashku. Deri tek pranimit i faqes së titullit dhe kapakut nuk dihet se cilat pjesë do të lidhen së bashku; kjo bëhet e qartë vetëm pas pranimit të faqes së titullit dhe kapakut.

Pjesa e veçantë inventarizohet në një fushë të re 996. Në numrin e vendit tek elementi d\x vendoset numri rendor i veprës.

Pas pranimit të faqes së titullit dhe kapakut, pjesët lidhen në një njësi. Në këtë mënyrë krijohet një njësi e re fizike, e cila inventarizohet si e pavarur në një fushë të re 996.

Në fushën 996 për pjesët, të cilat i keni lidhur në një njësi, vendosni shenjën e burimit të integruar në këtë mënyrë: në redaktuesin **Fusha 996/997** në skedën **e,g,h,i,s,w,4,5** tek "Burimi i integruar (g\I)" përzgjidhni vlerën *i – shtojcë, përditësim, pjesë etj., e integruar në njësinë kryesore; nuk shfaqet në COBISS+*. Në këtë mënyrë fushat e përzgjedhura:

- nuk shfaqen në COBISS+ dhe në katalogun për huazim;
- nuk janë të disponueshme për rezervim ose huazim;
- përjashtohen nga inventari;
- respektohen në statistkat e rritjes, përjashtimit dhe koleksioneve të bibliotekës (si në numër ashtu edhe në aspektin financiar).

Tek këto fusha 996 vendosni edhe shënimin për inventarizimin në nënfushën 997r, p.sh.: *integruar në IN=<numri_i_inventarit_të_pakos>*.